VENDIM
Nr.114, datë 16.11.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DITEKO" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET NË LUMIN "ZALLI I OKSHTUNIT": "BOROVË", "ZABZUN", "SEBISHT", "PRODAN 1", "PRODAN 2", "OKSHTUN EKOLOGJIK", "TËRNOVË", "OKSHTUN", "LUBALESH 1", "LUBALESH 2" DHE "GJORICË"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a", 5 pika 1 germa "a", 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Diteko" sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Diteko" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë "Diteko" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et në lumin "Zalli i Okshtunit ": "Borovë" me fuqi 1,921 MW, "Zabzun" me fuqi 0,301 MW, "Sebisht" me fuqi 2,835 MW, "Prodan 1" me fuqi 0,38 MW, "Prodan 2" me fuqi 0801 MW, "Okshtun ekologjik" me fuqi 0,45 MW, "Ternovë" me fuqi 0,921 MW, "Okshtun" me fuqi 10 MW, "Lubalesh 1" me fuqi 4,6 MW, "Lubalesh 2" me fuqi 5,1 MW dhe "Gjoricë" me fuqi 4,18 MW, për një periudhë 30-vjeçare.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani